

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës
Nr. 02-59/20-07
Prishtinë, më 27 gusht 2007
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Sabri Hamiti**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 75 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të 27 e 31 dhe 30 korrikut 2007;
2. Koha për pyetje parlamentare;
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët, nr. 2003/11;
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për organizimin e institucioneve të Kadastrit;
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis;
6. Shqyrtimi i Raportit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2006;
7. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për bartjen e mjeteve buxhetore të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2007;
8. Shqyrtimi i Projektrezolutës për KXM “Trepça”, të propozuar nga Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Miniera, Transport dhe Telekomunikacion;
9. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me propozimin e Prokurorisë Publike të Kosovës për emërimin e një anëtari në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Në fillim të seancës, **kryetari** i njoftoi deputetët e pranishëm se Kryesia e Kuvendit, në bazë të rregullave 6 dhe 23 të Rregullores së punës së Kuvendit e ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme. Ndërkohë, Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë dhe Miniera ka propozuar që Kuvendi ta nxjerrë një Deklaratë lidhur me KXM “Trepça”.

Deputetja **Besa Gaxheri**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, propozoi që Kuvendi të marrë vendim që fotografia e ish- Kryetarit të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, të vendoset në të gjitha zyret e institucioneve publike të Kosovës.

Deputeti **Gjegj Dedaj** kërkoi që deputetët e Kuvendit të informohen lidhur me mbajtjen e zgjedhjeve në Kosovë.

Kryetari tha se propozimet duhen të parashtrihen me shkrim, në përputhje me rregullat procedurale të punës së Kuvendit.

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të 27 dhe 30 korrikut 2007

Procesverbalet e seancave plenare të 27 dhe 30 korrikut 2007 u miratuan pa vërejtje.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Xhevat Bislimi** i parashtroi pyetje ministrit të Energjetikës dhe të Minierave lidhur me furnizimin dhe lirin nga pagesa e rrymës elektrike për banorët fshatrave të komunës së Kastriotit, afër termoelektraneve.

Ministri **Ethem Çeku** iu përgjigj pyetjes së deputetit Bislimi.

Deputeti **Emrush Xhemajli** i parashtroi pyetje ministrit të Drejtësisë lidhur me mosekzekutimin e lëndëve të përfunduara nëpër gjykatat e Kosovës.

Ministri **Jonuz Salihaj** iu përgjigj pyetjes së deputetit Xhemajli.

Deputeti **Xhelal Canziba** i parashtroi pyetje ministrit të Transportit dhe të Posttelekomunikacionit lidhur me asfaltimin e rrugës që lidh Therandën me Rahovecin.

Ministri **Qemajl Ahmeti** iu përgjigj pyetjes së deputetit Canziba.

Deputeti **Nait Hasani** i parashtroi pyetje kryeministrit të Kosovës, z. Agim Çeku, lidhur me furnizimin e bizneseve me derivate të mazutit.

Kryeministri **Çeku** iu përgjigj pyetjes së deputetit Hasani.

Deputetja **Sala Ahmetaj** i parashtoi pyetje ministrit të Transportit dhe të Posttelekomunikacionit lidhur me asfaltimin e rrugës së fshatit Radishevë.

Ministri **Qemajl Ahmeti** iu përgjigj pyetjes së deputetes Ahmeti.

Deputetja **Sala Ahmetaj** i parashtoi pyetje kryeministrit të Kosovës, z. Agim Çeku, lidhur me paraqitjen e grupeve të armatosura në fshatin Radishevë.

Kryeministri **Çeku** tha se deputetes do t'i përgjigjet në seancën e radhës.

Deputeti **Ramadan Kelmendi** i parashtoi pyetje ministrit të Shëndetësisë lidhur me mbylljen e barnatoreve shoqërore dhe problemet e furnizimit të qytetarëve me barna.

Ministri **Sadik Idriz** iu përgjigj pyetjes së deputetit Kelmendi.

Deputeti **Jonuz Kastrati** i parashtoi pyetje ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor lidhur me gjendjen e krijuar në Ujëvarën e Mirushës.

Ministri **Ardian Gjini** iu përgjigj pyetjes së deputetit Kastrati.

Deputeti **Xhevat Bislimi** i parashtoi pyetje kryeministrit të Kosovës, z. Agim Çeku, lidhur me angazhimin e studentëve, që kanë mbaruar studimet jashtë vendit, nëpër institucionet publike të vendit.

Kryeministri **Agim Çeku** iu përgjigj pyetjes së deputetit Bislimi.

Koha që ishte e paraparë (50 minuta) për pyetje dhe përgjigje mbaroi, për pyetjet e tjera të parashtrua përgjigjet mbetën të jepen në seancën e ardhshme.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët

Kryetari e ftoi propozuesin ta arsyetonte këtë Projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Transportit dhe i Postëtelekomunikacionit, **z. Qemajl Ahmeti**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët.

Në vazhdim ministri **Ahmeti** shpjegoi materien, objektivat e Projektligjit dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri Ahmeti, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Ibush Jonuzi**; në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Hatixhe Hoxha**; në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; **Xhevdet Neziraj**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s; **Gazmend Muhaxheri**, në emër të Grupit Parlamentar 6 Plus, **Mahir**

Yagcilar, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Milazim Haliti** dhe në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, **Vezira Emrush**.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----67;

Kundër----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, njëzëri, e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion - Komision Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për organizimin e institucioneve të Kadastrit

Kryetari e ftoi propozuesin ta arsyetojë këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministrja e Shërbimeve Publike, **znjsh. Melihate Tërmkolli**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim, ministrja **Tërmkolli** e arsyetoi qëllimin, objektivat, materien që e rregullon Projektligji për organizimin e institucioneve të Kadastrit, pjesën përfundimtare, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij Projektligji nga ana e ministres **Tërmkolli**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Kryetarja e Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, znj. **Nekibe Kelmendi** tha se Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin për organizimin e institucioneve të Kadastrit dhe ka konstatuar se materia që e normon ky projektligj është e rregulluar me Ligjin për kadastrin dhe me Rreguloren e UNMIK-ut nr.2000/45. Andaj, në emër të Komisionit Funkcional i rekomandojë Kuvendit që t'ia kthejë propozuesit - Qeverisë së Kosovës Projektligjin për organizimin e institucioneve të Kadastrit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Alush Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Nerxhivane Dauti**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Mazllom Kumnova**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, **Teuta Sahaqija**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Ramadan Kelmendi** dhe në emër të Grupit Parlamentar 6 Plus, **Shpresa Murati**, diskutimet e të cilëve i janë bashkangjitur transkriptit.

Në fund, ministrja **Tërmkolli** dha sqarime lidhur me vërejtjet e deputetëve dhe kërkoi që Kuvendi ta miratojë Projektligjin për organizimin e institucioneve të Kadastrit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 25;
Kundër----- 30.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

Nuk miratohet në parim Projektligjin për organizimin e institucioneve të Kadastrit.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis

Kryetari e ftoi propozuesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Mjedisit dhe i Planifikimit Hapësinor, z. **Ardian Gjini**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim, ministri **Gjini** shpjegoi materien, objektivat, strukturën e Projektligjit, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri **Gjini**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Shaban Halimi**; në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Selville Halimi**; në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Mazllom Kumnova**; në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, **Gazmend Muhaxheri**; në emër të Grupit Parlamentar 6+, **Mahir Yagcilar**; në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Ramadan Kelmendi** dhe në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, **Vezira Emrush**, si dhe deputetët: **Naxhije Doçi**, **Nimon Alimusaj**, **Sala Berisha-Shala**, **Nekibe Kelmendi** dhe **Rifat Krasniq**, të cilat i janë bashkangjitur transkriptit.

Në fund, ministri Ardian Gjini dha sqarime lidhur me vërejtjeve në Projektligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 63;
Kundër----- 6;

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash e miratoi në parim Projektligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor - Komision Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj, brenda dy muajve dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

6. Shqyrtimi i Raportit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2006

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Komisionit FunkSIONAL ta marrë fjalën.

ibush Jonuzi, në emër të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion dhe të Grupit Parlamentar të LDK-së, - tha se Raporti i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2006 është përmbajtjesor, gjithëpërfshirës, i strukturuar mirë dhe në të janë referuar saktë detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga ligji.

Komisioni FunkSIONAL dhe Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështesin këtë raport dhe kërkojnë që Zyra e Rregullatorit të Energjisë të plotësohet me staf profesional, si dhe të emërohet anëtar i Bordit, që mungon.

Kryetari e hapi debatin për Raportin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2006.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Raportin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2006 dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Bajrush Xhemajli**; në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Mazllom Kumnova**; në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, **Teuta Sahatqija**; në emër të Grupit Parlamentar 6+, **Mahir Yagcilar**; në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, **Vezira Emrush** dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Ramadan Kelmendi**, si dhe deputeti **Behxhet Brajshori**, të cilat i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votim Raportin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2006. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për.....47,

Kundër..... 8.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi Raportin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2006.

7. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për bartjen e mjeteve buxhetore të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2007

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Komisionit të Buxhetit dhe të Financave ta arsyetojë Rekomandimin para deputetëve të kuvendit.

Kryetari i Komisionit të Buxhetit dhe Financave, z. **Naser Osmani**, e arsyetoi Rekomandimin e Komisionit për bartjen e mjeteve buxhetore të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë nga kategoria e mallrave dhe e shërbimeve në kategorinë e pagesave dhe të ardhurave.

Kuvendi, pasi e shqyrtoi Rekomandimin e Komisionit, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

Kuvendi i Kosovës miratoi kërkesën e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për bartjen e mjeteve financiare, në shumën prej 45.000,00 €, nga kategoria e mallrave dhe e shërbimeve në kategorinë për paga dhe mëditje.

8. Shqyrtimi i Projektrezolutës për KXM “Trepça” të propozuar nga Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Miniera, Transport dhe Telekomunikacion

Kryesuesi i seancës, z. **Sabri Hamiti**, e ftoi propozuesin ta arsyetojë Projektrezolutën para deputetëve të Kuvendit.

Kryetari i Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Miniera, Transport dhe Telekomunikacion **Ibush Jonuzi**, tha se Komisioni Funksional vazhdimisht ka qenë i preokupuar se çka po bëhet me Trepçën? Komisionin vazhdimisht e ka shqyrtuar çështjen e “Trepçës”. Por, shqetësimi ka arritur kulminacionin atëherë kur kemi marrë informata se Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm do të emërojë një administrator, i cili ka për detyrë riorganizimin dhe privatizimin e Trepçës.

Pas një debati të gjerë, që kemi pasur me të gjithë ata që janë marrë me çështjen e Trepçës, Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2007, ka ardhur në përfundim që ta hartojë një Projektrezolutë lidhur me KXM “Trepça” dhe t’ia paraqesë Kuvendit për miratim.

Pas kësaj kohe kanë pasuar presionet dhe reagimet nga të gjitha nivelet, duke filluar prej AKM-së, Shtyllës së IV të UNMIK-ut, PSSP-së, USAI-dit dhe Zyrës Amerikane.

Komisioni është informuar për ngritjen e tensioneve rreth hartimit të kësaj rezolute. Pas një takimi të përbashkët, të thirrur nga Përfaqësuesit Special, me kryetarin i Kuvendit, kryeministrin e Qeverisë, ministrin e Energjetikës dhe Minierave, ministrin për Tregti dhe Industri, ministrin për Buxhet dhe Financa, përkatësisht përfaqësuesin e tij, është kërkuar nga Komisioni që për një kohë ta prolongojë kërkesën e vet për nxjerrjen e një rezolute.

Komisioni në mbledhjen e sotme shqyrtoi të gjitha kërkesat dhe erdhi në përfundim që të shtyhet miratimi i Rezolutës për dy javë.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e kryetarit të Komisionit Funksional që miratimi i Rezolutës lidhur me KXM “Trepça” të shtyhet për dy javë. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 47;

Kundër----- 13.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi, me shumicë votash, miratoi propozimin e Komisionit Funksional që miratimi i Rezolutës lidhur me KXM “Trepça” të shtyhet për dy javë

9. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me propozimin e Prokurorisë Publike të Kosovës për emërimin e një anëtari në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Zëvendëskryetari i Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, z. **Sadudin Berisha**, e arsyetoi Rekomandimin e Komisionit lidhur me propozimin e Prokurorisë Publike të Kosovës për emërimin e një anëtari në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Kryesuesi e hodhi në votim Rekomandimin e Komisionit. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për ----- 55,

Kundër----- 12.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

1. Anëtar i Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, nga Prokuroria Publike e Kosovës, emërohet z. Vesel Jashari.
2. Mandati i anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës zgjatë dy vjet.

Kryesuesi e deklaroi seancën të mbyllur në orën 14: 30 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë Berisha

E hartoi

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale